

BULETINI 8

1

Ka përfunduar me sukses pilotimi “Të Mësuarit në Vendin e Punës”



Projekti Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE) është duke bashkëpunuar me shkollat e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP) dhe kompanitë private për të filluar të mësuarit në vendin e punës në formë të praktikës në punë. Në janar filluan pilotimet në komunitet e Kaçanikut, Ferizajit, Gjakovës dhe Vushtrrisë, me fokus në sektorët e prodhimit dhe shitjes me pakicë. Si pjesë e praktikës së tyre, studentët punuan prej periudhës 15 janar deri në përfundimin e vitit shkollor 15 maj, dy herë në javë. Në fazën e pilotuar, u regjistruan gjithsej 35 studentë, që punuan në 6 kompani të ndryshme. Deri në fund të stazhit, 22 studentë e përfunduan me sukses praktikën në punë, prej të cilëve 5 iu sigurova kontrata me orar të plotë.

Gjatë vitit të ardhshëm EYE do të zgjerohet në tri komunitet e Prishtinës, Vitisë dhe Prizrenit dhe do të vazhdojë me modelin “Të mësuarit në Vendin e Punës” në komunitet e pilotuara duke filluar me klasën e 11'të dhe 12'të

2

U mbajt kongresi ndërkombëtar i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional



Për t'u ofruar partnerëve informata më të hollësishme rreth sistemit dual të arsimit në Zvicër dhe metodologjisë “Të Mësuarit në Vendin e Punës”, EYE ka ftuar Jonuz Salihajn – drejtorin e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës dhe tre përfaqësuesit e kompanive partnere (Ariel Shabani – KIVO, Yllka Metaj Shaqiri – Aztech, Lekë Zherka – BoneVET) për të marrë pjesë në Kongresin e tretë Ndërkombëtar të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional që u zhvillua prej 6 deri më 8 qershor në Winterthur, Zvicër. Ky kongres ishte një mundësi e shkëlqyer për partnerët e projektit EYE që të njihen për së afërmi me implementimin e sistemit dual AAP-së të Zvicrës

dhe partneritetet e ngushta me kompanitë dhe shkollat e AAP-së. Gjatë ngjarjes treditore, Kongresi organizoi një sërë vizitash në terren, ku pjesëmarrësit kishin mundësi t'i vëzhgojnë dhe të komunikojnë me praktikantët dhe instruktorët e kompanisë mbi implementimin e sistemit dual të arsimit. Ekspozimi ndaj përvojës zvicerane ishte mjaft i vlerësuar nga ana e partnerëve.



3

Lansimi i kampanjës mediale të AAP “KUSH IA KA PA HAJRIN SHKOLLËS?!”

Me datën 21 qershor, në sheshin kryesor të Prishtinës “Zahir Pajaziti”, ylli i muzikës pop Yll Limani performoi para audiencës së të rinjve. Prapa kësaj zbatimjeje qëndron një mesazh i rëndësishëm për studentët e klasave të 9ta të shkollave fillore, prindërit dhe politikbërësit përfshirë publikun e gjërë. Kampanja “Kush ia ka pa hajrin shkollës?!” pritet që të nisë një kampanjë të madhe mediale e cila do të ofronte informata më të sakta rreth zgjedhjeve të karrierës në AAP dhe tregun e punës. Përveç kësaj, kjo kampanjë ka për qëllim stimulimin e debatit më të gjerë publik rreth Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë. Bazuar në anketën më të fundit të kryer nga EYE rreth perceptimit të AAP, u konstatua se “ndonëse prindërit (që janë këshilltarët e

nxënësve më me ndikim në lidhje me karrierën e tyre) e pranojnë vlerën e të punësuarit si rezultat i arsimit profesional, ata akoma do të dëshironin që fëmijët e tyre të vijonin studimet në profesionet “prestigjioze” të tilla si juridiku, mjekësia dhe profesionet e orientuara kah shkenca” duke i lënë kështu profesionet e orientuara kah teknika si zgjedhje e dytë ose e tretë. Si rrjedhojë, përmes kësaj kampanje, e cila do të zgjasë prej muajit maj deri në fund të vitit, do të përfshihen një sërë temash rreth mundësive në tregun e profileve AAP, që është një arsim i cili mundëson tranzicionin më të shpejtë nga shkolla në punësim, në përputhje me kërkesën reale të tregut.

4

Zhvillimi i modelit “Qendra për karrierë në shkollë” për shkollat e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë

Në përputhje me objektivat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të nxitur zhvillimin e shkathtësive për menaxhim të karrierës midis studentëve të AAP, në mënyrë që të parandalohet braktisja e hershme e shkollës dhe të bëhet ndërlidhja e sistemit arsimor me tregun e punës (punësueshmëria), EYE dhe MASHT janë të përkushtuar që të zhvillojnë modelin “Qendra për karrierë në shkollë” për shkollat AAP nëpër komunat me përmasa të mesme.

Prej 26 shkurt deri më 1 mars është organizuar një punëtori dyditore në Prishtinë që ka pasur për



BULETINI 8

qëllim t'ua prezantojë institucioneve relevante dhe palëve të interesuara karakteristikat kryesore të modelit “Qendra për karrierë në shkollë” që është konceptualizuar përmes praktikave më të mira dhe mësimëve të nxjerra nga dy pilot-qendrat e karrierës në komunat e Vushtrisë dhe Prishtinës. Përvoja shtesë është ofruar nga organizata Business Foundation for Education, e cila është një lidere e njohur në arsimin tërëjetësor dhe orientimin për karrierë në Bullgari.

Gjatë punëtorisë, nga ana e katër shkollave AAP u nënshkrua një koncept-dokument për zhvillimin e modelit “Qendra për karrierë në shkollë” ku edhe do të themelohet Qendra e re për karrierë. Këto janë shkollat e AAP-së: “Zenel Hajdini” në Ferizaj, “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” në Kaçanik dhe “Shaban Spahija” në Pejë. Projekti EYE do të vazhdojë të ngrisë kapacitetet e këtyre Qendrave të reja për karrierë në mënyrë që të fillojë t’u ofrojë nxënësve shërbime për orientim në karrierë duke filluar me vitin e ri shkollor 2018-2019.

5

Konsulenca.org, Platforma Online për Vlerësimin e Konsulentëve


EYE ka formuar një partneritet strategjik me BCC (Business Consultants Council) për të krijuar platformën online Konsulenca.org për kompanitë konsultative dhe për konsulentët e pavarur, në mënyrë që të rritet transparencja dhe stimulohet performanca më e lartë në treg për shërbimet konsultative. Deri më tani, në këtë platformë janë regjistruar më shumë se 160 konsulentë dhe më shumë se 16 vlerësime. Në muajin qershor BCC nënshkroi një Memorandum të Mirëkuptimit me nëntë shoqata të biznesit për shfrytëzimin e platformës si një burim për të gjetur shërbime konsultative profesionale. Përveç kësaj, janë përgatitur edhe disa video për rëndësinë e platformës, të cilat përmes mediave sociale u janë shpërndarë mbi 60,000 personave.

Qëllimi i kësaj platforme është krijimi i një transparence të eksperiencave dhe referencave të konsulentëve duke frymëzuar besim midis klientëve potencial.

Konsulenca.org është platformë për vlerësimin e konsulentëve e cila do të nxisë konkurrencën për përmirësimin e cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve konsultative në Kosovë.

Kjo platformë planifikohet të bëhet një mjet i përshtatshëm për ndërlidhjen e konsulentëve dhe bizneseve. Ndryshimi kryesor që kjo platformë parashikon është vendimmarrja që bazohet mbi informacionin që ka të bëjë me cilësinë dhe referencat e konsulentëve. Për më shumë informata rreth konsulenca.org shikoni videon:

https://www.youtube.com/watch?time_continue=3&v=v4jU4a7qDfE



Kampi për Trajnimin e Ndërmarrjeve Shoqërore

Në qershor të vitit 2018, në malet e Rugovës 10 ndërmarrje shoqërore morrën pjesë në njërin prej katër kampeve të trajnimit treditor që do të mbahen gjatë këtij viti. Ky aktivitet ishte pjesë e projektit "Mbështetja strategjike për ndërmarrjet shoqërore në Kosovë" që financohet nga EYE dhe të cilën e kryeson LENS, një OJQ vendore, në partneritet me Indira Kartallozin, një eksperte në ndërmarrësi shoqërore. Ndërmarrësit kishin mundësinë të mësojnë rreth temave që përfshijnë trendet globale, domethënjën e ndikimit shoqëror dhe rridhjen e misionit, vizionit dhe vlerave të tyre.




Përveç kësaj, ndërmarrësit shoqëror shfrytëzuan fundjavën që të rrjetëzohen dhe ekspozohen me veprimet e ndryshimtarëve tjerë në Kosovë duke mësuar nga përvojat e njëri-tjetrit. Pjesëmarrësit do të vazhdojnë rrugëtimin e tyre me tre kampe tjera të trajnimit që do të organizohen gjatë këtij viti, ku do të përfshihen temat e financave, modeleve të biznesit dhe prezantimit në shtator, tetor dhe nëntor. Kjo përvojë do t'i hapë disa dyer për ndërmarrësit shoqëror që të zhvillohen, të bëhen më të qëndrueshëm dhe të kenë ndikim më të madh në shoqëri.

KONTAKTET

Projekti Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE)
Rr. Nazim Gafurri, nr.33, Po Box 2
10000 Prishtina, Kosovo
www.facebook.com/eyekosovo/

Mbështetur nga:

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for development
and Cooperation SDC

Implementuar nga:

 **HELVETAS**
KOSOVO

Management
development
Associates **MDA**